

Shkrimtari i skenarit. Skenari

Skenari i filmit është përmbajtje e shkruar e filmit mundësisht me sa më tepër aksion dhe me mundësi që me pamje filmike të zbërthehet premisa artistike dhe ideore e autorit

Sekuencat e skenarit i ngjasojnë kapitujve të librit janë

Për ndryshim nga shfaqja teatrore ose romani, skenari për film kurrë nuk ka arritur të bëhet vepër letrare. Si plani në arkitekturë, edhe ai është vetëm një fazë nëpër të cilën duhet të kalojë një vepër për të marrë formë përfundimtare.

Pozita e atyre që shkruajnë skenarë për film në Holivud nuk mund të krahasohet me pozitën e atyre që shkruajnë tekste për realizime nga fushat e tjera.

Shkrimtarët e dramave, edhe nga aspekti i tekstit, por edhe interpretues, zakonisht në skenë i shohin veprat e tyre afërsisht në atë formë që i kanë shkruar, përjashtimisht rastet kur thirret ndonjë ekspert për të bërë ndonjë ndryshim drejt përsosjes. Atij që shkruan fejtone rrallë i ndodh që redaktori të bëjë ndryshime të mëdha në tekstin e tij. Shkrimtarit të romanit shumë rrallë i ndodhë që diçka esenciale t'i ndryshohet nga botuesi. As atyre që shkruajnë për radio, redaktorët nuk ua ndryshojnë aq shumë tekstin. Por ajo që duhet të quhet vepër autoriale për shkrimtarin e skenarit në Hollivud, **shumë rrallë ose kurrë nuk ndodhë të arrijë në ekran pa ndryshime esenciale.**

Për këtë ekzistojnë shumë arsye. Xhirimi i filmit është punë kolektive. Për një vepër filmike është e nevojshme punë kreative e shumë krijuesve nga fushat e ndryshme të artit dhe të mjeshtërive, siç është aktrimi, fotografia, arkitektura, skenografia, kostumet, dekorimi i brendshëm dhe shumë të tjera, të gjitha këto shumë të nevojshme dhe të pazëvendësueshme për xhirimin e një filmi.

Që të kemi një përfytyrime të përafërt se çfarë punësh të ndryshme duhet bërë për xhirimin e një filmi, do të përmendim të gjithë ata që kanë qenë të pranishëm në një moment të xhirimit të filmit „Tehu i briskut“ sipas romanit të Somerset Maugham-it.

Përveç regjisorit dhe dy asistentëve të tij, aktorëve dhe dublantëve të tyre, ishin aty edhe ndriçuesi dhe asistentët e tij, drejtori i fotografisë me dy ndihmësit e tij, kameramani, mjeshtri i kranit, mjeshtri i farit, udhëheqësi i xhirimit me pesë ndihmësit e tij, sekretari i regjisë, redaktori i dialogut, drejtori i filmit, shefi i propagandës, mjeshtri i skenës, ekzekutuesi i efekteve speciale, regjistruesi i tonit dhe ndihmësi i tij, eksperti për efekte tonike, eksperti për teknikën e zërit, rekuizitori me ndihmësit e tij, dy grimerë, parukeri, dy garderoberë dhe një fotograf.

Mund të vëreni se shkrimtari i skenarit aty nuk ishte i pranishëm. Edhe shkrimtari i romanit nuk është prezent në shtypshkronjë

Ishin të pranishëm vetëm ata që vërtet kishin punë në vendin e xhirimit. Nuk përmendëm këtu edhe qindra të tjerë, puna e të cilëve ka qenë e domosdoshme në faza të ndryshme të xhirimit të filmit – që nga skenografi e deri te ai që do të pastrojë atelienë pasi të xhirohet filmi dhe të hiqet dekori. Madje edhe atëherë kur xhirohet ndonjë dramë televizive pa pretendime të mëdha në ndonjë studio të vogël dhe me personel të huazuar, numri i njerëzve të përfshirë në këtë proces është vërtet befasues.

E pamë se skenari, pasi të shkruhet, kërkon edhe shumë punë plotësuese dhe talent, por ky nuk është dallimi kryesor ndërmjet skenarit dhe llojeve të tjera të krijimtarisë letrare. Ekzistojnë edhe dallime të tjera, madje shumë të rëndësishme.

Romani (gati gjithmonë) dhe drama (pothuajse gjithnjë) shkruhen drejtpërdrejt për publikun. Shkrimtari i skenarit, përkundrazi, shkruan një mori udhëzimesh për regjisorin, aktorët, xhiruesin dhe punëtorët të tjerë që marrin pjesë në xhirimin e një filmi. Për këtë shkak, skenari asnjëherë nuk shkruhet për t'u lexuar nga publiku i gjerë. Për këtë arsye ka aq pak skenarë të botuar. Por edhe kur botohen, prej tyre hiqen udhëzimet për kamerë dhe aktorë.

Me rastin e vlerësimit të skenarit, nuk është e rëndësishme se si tingëllon ai kur lexohet, por sa arrin t'i përshkruajë në mënyrë efektive skenat që duhet të xhirohen, dialogët që duhet të dëgjohen, apo ngjarjet dhe ndodhitë që duhet të interpretohen. Për këtë arsye ka aq shumë shkrimtarë dhe dramaturgë që pësojnë mosesukses të plotë kur i thërrasin në Holivud për të shkruar skenarë. Atë që shkruajnë ata janë gjëra të mrekullueshme për lexim. Dialogët e tyre, të gjatë si në romane, kanë patos, ndjeshmëri dhe vërtetësi. Përshkrimet e personazheve, veprimet dhe motivimi i tyre janë vërtet të shkathëta dhe të këndshme për lexim.

Por nëse nuk merret një shkrimtar skenari me përvojë, i cili në mënyrë profesionale do t'i përpunojë tekstet e tyre, një skenar i tillë do të nxjerrë si rezultat një film të dobët. Nga shiriti tonik, një dialog i tillë i shkruar bukur në roman, do të dalë krejt i zakonshëm dhe jokreativ. Përshkrimet e gjata të veprimit të personazheve, derisa të arrijnë te aktrimi, do të shkapërderdhen plotësisht. Kurse udhëzimet joprofesionale për kamerë as për regjisorin nuk do të kenë ndonjë rëndësi, kështu që ai, si zakonisht, do t'i xhirojë skenat ashtu siç i mendon ai se është më së miri.

Nga e gjithë kjo del se një shkrimtar i mirë i romanit nuk është e domosdoshme të jetë edhe shkrimtar skenarit të përshtatshëm për film.